

VENDIM
Nr.674, datë 21.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA KURJAN TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kurjan të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 6 (gjashtë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kurjan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj)

Institucioni i pushtetit qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE										
Komuna: Kurjan										
Fusha e përdorimit të pronës: pyll										
Nr. rend.	Nr. Inv. sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullusore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip. ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	83	Seman 2	Qafa e pyllit	9	Trung	15.5	Prodhues	MMPAU	DSHP Fier	
2	84	Seman 2	Kurrizi i Dunit	10/a	Shkurre	20.2	Prodhues	MMPAU	DSHP Fier	
3	86	Seman 2	Pylli i Mbersit	11	Cung	9	Prodhues	MMPAU	DSHP Fier	
4	87	Seman 2	Perroi i Kurjanit	12/a	Sip.bimes	1	Prodhues	MMPAU	DSHP Fier	
5	88	Seman 2	Perroi i Kurjanit	12/b	Sip.bimes	3	Prodhues	MMPAU	DSHP Fier	
6	89	Seman 2	Perroi i Kurjanit	12/c	Sip.bimes	1.5	Prodhues	MMPAU	DSHP Fier	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna **Kurjan**

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
83-84, 86-89	Pyll, sipërfaqe me bimësi pyjore	Në pronësi